

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.2, SH.A
NJËSIA E PROKURIMIT

PROCES - VERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje lëndë djegëse Gazoil për kaldajat”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karburant Diesel 09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

4,265,414 (katër milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Rezidenca Studentore Universitare Nr.2 Sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4; ne masen 2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës në një nga format e parashikuara në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, perkatesisht në vlerën prej 85,308.00 lekë pa tvsh.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, Sipas Shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 (të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

2.1.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 14001:2015 (të vlefshme) ose ekuivalentetë tij të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

Argumentim: Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë", është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron.

Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikatën ISO 14001:2015, ose ekuivalente me të "Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit", lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të mjedisit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2022,2023,2024, sipas 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43 si dhe nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi tëArdhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore të vitit 2022,2023,2024 që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat

perfundimtar për tu mbyllur dhe dorezuar pranë organeve tatimore maksimumi deri në fund të muajit Prill të vitit që vjen. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, sipas nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licensë karburantesh me shumicë ose pakicë, për objektin e prokurimit (Gazoil).

Operatori ekonomik duhet të ngarkojë në sistem dokumentin e kërkuar provues bashkë me dokumentet e tjera kualifikuese

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe

Në zbatim të Ligjit nr.8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin,transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve, VKM nr.344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr.970, datë 02.12.2015” “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”,

2.3.3. Vërtetim të lëshuar nga ISHTI që subjekti ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2025.

Operatori ekonomik duhet të ngarkojë në sistem dokumentin e kërkuar provues bashkë me dokumentet e tjera kualifikuese

Argumentimi: Në lidhje me këtë pike operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim që leshohet nga ISHTI, ku të referon kërkesat e mesipërme në funksion dhe zbatim të ligjit Nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Rrepublicën e Shqipërisë”, si dhe Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

Ky kriter është i rëndësishëm, pasi garanton AK-ne që Operatori Ekonomik ofertues ofron cilësi duke respektuar standartet Ligjore si dhe respekton normat dhe të gjitha masat mbrojtëse duke ofruar produkt sipas standarteve bashkekohore. Vërtetimi i lëshuar nga ky institucion na siguron që ofrohet furnizim cilësor si dhe operatori ekonomik ofertues zbaton kushtet e parashikuara në lejet apo autorizimet perkatese për ushtrimin e aktivitetit.

2.3.4. Operatori të ketë në dispozicion 24 orë 1(një) autobot për transportin e lëndës djegëse e vërtetuar me akt shit blerje ose kontratë qeraje. Për të vërtetuar këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe dokumentacion e mjetit për transport gazoili si më poshtë:

Leje qarkullimi

Akt kolaudimi mbi kontrollin teknik të mjetit

Polisë sigurimi

Certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm brenda vëndit

Taksat vjetore

ADR

Akt teknik të lëshuar nga PMNZSH

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues të kërkuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Për efekt të verifikimit të gjendjes gjyqësore Operatorët Ekonomik së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të sjellin edhe fotokopjen e certifikatës personale të administratorit ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti) ose dëshminë e penaltetit.

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e certifikatës personale të administratorit të shoqërisë ose të ortakëve të shoqërisë (nëse është rasti).

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Njoftimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1155/prot., datë 01.02.2019 dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.1001/1 prot., datë 01.02.2019).

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR GAZOIL

Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike.

Specifikimet teknike janë të dhëna teknike që i referohen standartit europian (EN) të adoptuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit që ka statusin e standarit shqiptar(S SH) ku specifikimet teknike për gazoil, duhet të jenë sipas **standartit SSHEN 590:2022** të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit si më poshtë:

Tipari	Njësia	Limitet		Metoda e testimit a
		min	Max	
Numër Cetane		51,0	-	EN ISO 5165:2020 b EN 15195:2014 EN 16715:2015 EN 16906:2017 c EN 17155:2018
Cetane index		46,0	-	EN ISO 4264
Hidrokarburet aromatike polikike d	% (m/m)	-	8,0	EN 12916:2019
Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846:2019 e EN ISO 20884:2019 EN ISO 13032:2012
Përmbajtja e manganit	mg/l		2,0	EN 16576:2014
Karboni i pikës së ndezjes	°C	Mbi 55,0	-	EN ISO 2719
Mbetje 8 (në 10% mbetje distilimi)	% (m/m)		0,30	EN ISO 10370
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	% (m/m)	-	0,020	EN ISO 12937
Ndotje totale	mg/kg	-	24	EN 12662
Gërryerje të shiritit të bakrit (3 orë në 50 °C).	Vlerësimi	Klasi 1		EN ISO 2160
Përmbajtja e metil	% (V/V)	-	7,0	EN 14078:2014

esterit të acidit yndyror (FAME).				
Stabiliteti i oksidimit 1	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
Stabiliteti i oksidimit për karburantin dizel që përmban FAME mbi 2,0 % (V/V)	Orë ose min	20,0 or 60,00		EN 15751 ose EN 16091
Lubriciteti, diametri i mbresë së veshjes (WSD) në 60°C	pm	-	460	EN ISO 12156-1 i
Viskoziteti at 40 °C	mm ² /s	2,000	4,500	EN ISO 3104 ^k ISO 23581
Distilimi m.n % (V/V) e rikuperuar në 250 °C % (V/V) e rikuperuar në 350 °C 95 % (V/V) e rikuperuar	% (V/V) % (V/V) °C	85	<65 360,0	ENISO 3405:2019 ⁿ EN ISO 3924:2019 EN 17306:2019 ^c

FAME do të plotësojë kërkesat e EN 14214:2014+A2:2019, shih [3].

1 Kërkesa për stabilitetin e oksidimit duke përdorur EN ISO 12205 zbatohet për të gjitha karburantet me naftë, pavarësisht nga përmbajtja FAME. Për karburantin dizel që përmban FAME mbi 2,0 % (V/V), ekziston një kërkesë shtesë për të testuar qëndrueshmërinë e oksidimit duke përdorur ose EN 15751 ose EN 16091. Shih gjithashtu 6.7.9.

i Lubriciteti i një karburanti dizel, pavarësisht nga përmbajtja e tij FAME, duhet të përmbushë kufirin HFRR prej maksimumi 460 pm. Karburanti dizel me një përmbajtje FAME që kalon 4,0 % (F/iq në përgjithësi ka lubrifikim të mirë me HFRR nën 460 pm dhe nuk kërkon domosdoshmërisht një test HFRR për sa kohë që nuk dihet ndonjë përvojë negative.

k Shih gjithashtu 6.7.8.

1 Për llogaritjen e indeksit të cetanit nevojiten gjithashtu pikat e rikuperimit 10 %, 50 % dhe 90 % (V/V).

m Kufijtë për distilimin në 250 °C dhe 350 °C janë përfshirë për karburantin dizel në përputhje me tarifën e përbashkët doganore të BE-së.

n EN ISO 3924:2019 jep udhëzime për të kthyer në të dhëna ekuivalente me ISO 3405. Shih gjithashtu 6.7.5.

Specifikimet teknike janë të dhëna teknike që i referohen standartit europian (EN) të adoptuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit që ka statusin e standartit shqiptar (S SH)

GRAFIKU I LËVRIMIT

Nr.	Lloji i karburantit	Sasia pritshme / litra
1	Gazoil	35880 (tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë)

Sipas tabelës më poshtë është e detajuar grafiku mujor i lëvrimit për gazoilin

Muaji	Kërkesa mujore në litra
Janar	4784
Shkurt	3588
Mars	3588
Prill	3588
Maj	3588
Qershor	2392
Korrik	2392
Gusht	0
Shtator	0
Tetor	3588
Nëntor	3588
Dhjetor	4784
Totali	35880

I. Argumentimi i përlogaritjes së vlerës së fondit limit:

Lidhur me përlogaritjen e fondit limit total në dispozicion për karburantin, AK argumenton se, ky fond përbëhet nga buxheti i shoqërisë për vitin 2026. Për përlogaritjen e fondit limit AK i është referuar çmimit të bursës PLATTS datë 03.02.2026. Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është ngritur grupi i punës për përlogaritjen e vlerës së fondit limit referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, neni 76.

Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit është bazuar në çmimin e bursës PLATTS datë 03.02.2026 dhe elementët fiskale.

Gjithashtu, sipas analizës së grupit të punës, bazuar në normativën e shpenzimit të karburantit dhe praktikës së harxhimit të tij në vitin e fundit ushtrimor, ka rezultuar si sasi e nevojshme e pritshme sasia e karburantit objekt prokurimi (sipas të dhënave në DST).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Hartimi i specifikime teknike të Gazoilit është bërë në përputhje me kërkesat që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” si dhe sipas Standardeve Shtetërore në fuqi që ato duhet të plotësojnë.

Sqarime; Certifikatat dhe deklaratat e kërkuara me siper janë të domosdoshme për ti dhënë garancitë e nevojshme autoritetit kontraktor lidhur me kapacitet teknike dhe ligjore që operatori ekonomik ka për të realizuar objektin e prokurimit.